

Përmbledhje

Ekonomia e eurozonës ka vazhduar rritjen e qëndrueshme gjatë vitit 2017, ndërsa inflacioni vazhdon të jetë nën objektivin e BQE-së përkundër rritjes së theksuar që pësoi krahasuar me vitet paraprake. Kushtet e favorshme të financimit të mbështetura nga politikat stimuluese monetare të BQE-së, optimizmi për prospektet e agjentëve ekonomikë dhe tregjeve financiare, si dhe rënia e pasigurisë politike ishin faktorët kryesorë mbështetës të konsumit dhe investimeve si faktor kontribuues në rritjen ekonomike në eurozonë. Përforsimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat u karakterizuan me rritje të eksporteve, investimeve si dhe konsumit.

Rritja e aktivitetit ekonomik në Kosovë gjatë vitit 2017 është mbështetur nga rritja e investimeve si dhe rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Sipas vlerësimeve preliminare të ASK-së, ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2017 ka shënuar rritje reale të BPV-së prej 3.7 përqind. Në rritjen e BPV-së reale kontributin kryesor e kishin ndërtimtaria, tregtia, aktivitetet financiare dhe të sigurimit si dhe industria përpunuese.

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, me përjashtim të ushqimeve, kanë vazhduar ecurinë e tyre rritëse me të cilën janë karakterizuar gjatë gjithë vitit 2017.

Si rezultat i rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, por edhe rritjes së aktivitetit ekonomik në vend, shkalla e inflacionit në vitin 2017 ka arritur një normë mesatare prej 1.5 përqind. Gjysma e parë e vitit është karakterizuar me një rritje më të lartë të çmimeve ndërsa në gjysmën e dytë, veçanërisht në tremujorin e fundit, trendi i rritjes së çmimeve është ngadalësuar.

Sektori fiskal gjatë vitit 2017 u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 5.3 përqind përkatësisht 5.0 përqind. Deficiti primar buxhetor si përqindja e BPV-së ishte 0.9 përqind, që është më i ulët krahasuar me deficitin prej 1.0 përqind në vitin paraprak. Përkundër rritjes së vazhdueshme të të hyrave, Kosova ka shkallën më të ulët të ngarkesës së ekonomisë me tatime krahasuar me vendet e rajonit ndërkohë që edhe raporti i shpenzimeve buxhetor por edhe ai i borxhit publik ndaj BPV-së është më i ulët krahasuar me vendet e rajonit.

Gjatë vitit 2017, sektori i jashtëm është karakterizuar me zhvillime pozitive në llogarinë rrjedhëse por edhe në atë financiare. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në raport me BPV-në është ulur në 6.4 përqind nga 7.9 përqind sa ishte në vitin 2016, ndërsa bilanci i llogarisë financiare ka arritur në 5.1 përqind të BPV-së nga 3.3 përqind sa ishte në vitin 2016. Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së suficitit në bilancin e shërbimeve, llogarisë së të ardhurave dytësore si dhe llogarisë së të ardhurave parësore, ndërsa deficiti në tregtinë e mallrave ka shënuar rritje. Në kuadër të llogarisë financiare, investimet e huaja direkte kanë shënuar rritje prej 30.8 përqind krahasuar me vitin 2016.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor	05
Ekonomia e Kosovës	08
Sektori Real	08
Çmimet	10
Regjistri i bizneseve	12
Sektori Fiskal	12
Sektori i Jashtëm	14

FIGURAT DHE TABELAT

Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në eurozonë	05
Figura 2. Normat kryesore të interesit në Zonën Euro	06
Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'	07
Figura 4. Çmimet e metaleve	08
Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë	08
Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit	09
Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private	09
Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë	10
Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë	11
Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit	11
Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit	11
Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit	11
Figura 13. Regjistri i bizneseve	12
Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja	12
Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave	14
Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive	15
Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive	15
Figura 18. Remitencat	16
Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve	17
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së	06
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik	19

SHKURTESAT:


APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistike të Bashkimit Evropian, në tremujorin e katërt të vitit 2017 ekonomia e eurozonës u rrit me rreth 2.7 përqind dhe 0.6 përqind në terma vjetor dhe tremujor, respektivisht. Gjatë gjithë vitit 2017, eurozona u karakterizua me rritje mesatare të BPV-së prej 2.7 përqind ndërkohë që gjatë vitit 2016, rritja ekonomike luhatej rreth vlerës 0.7 përqind (figura 1). Për dallim nga koncentrimi më i madh i rritjes ekonomike në disa nga shtetet qendrore gjatë viteve paraprake, në vitin 2017 përgjithësisht dhe tremujorin e katërt veçanërisht, rritja e aktivitetit ekonomik ishte më e shpërndarë ndërmjet shteteve dhe sektorëve ekonomik. Ekonomia në eurozonë është karakterizuar me vlera të larta të indekseve të besimit, përmirësim të treguesve të tregut të punës dhe tregjeve të patundshmërive, kushte të favorshme të financimit të mbështetura nga politikat stimuluese monetare të BQE-së si dhe rritje të kërkesës së jashtme si rezultat i përmirësimit të prospekteve në ekonominë globale. Sipas projeksioneve të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), në tre vitet e ardhshme, eurozona pritet të karakterizohet me rritje të qëndrueshme ekonomike, ndjeshëm mbi nivelin potencial. Projektioni për rritjen e BPV-së reale në eurozonë për vitin 2018 është rishikuar për lartë, në vlerën 2.3 përqind.

Përkundër përforsimit të aktivitetit ekonomik në eurozonë, zhvillimet e përgjithshme në çmime tregojnë për presione të dobëta inflacioniste përgjatë vitit 2017. Në tremujorin e fundit të vitit 2017, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve në eurozonë


qëndroi nën objektivin e BQE-së në 1.3 përqind (figura 1). Pritshmëritë për vlerësim të valutës euro kundrejt shportës së valutave tjera pritet të vazhdojë t'i mbajë presionet inflacioniste të moderuara.



Në tetor dhe në dhjetor të vitit 2017, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind) (figura 2). BQE-ja pritet të vazhdojë të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të refinancimit të pandryshuar edhe përtej përfundimit të programit të lehtësimit sasior apo blerjes së aseteve. Nga muaji janar 2018 deri në shtator 2018, apo edhe më tutje në rast të nevojës, BQE pritet t'i shpenzoj 30 miliardë euro në muaj për blerje të aseteve si pjesë e masave stimuluese monetare. Normat e kreditimit ndër-bankar Euribor 1 mujor dhe 12 mujor vazhdojnë të jenë në territor negativ rreth vlerës (-0.37 përqind dhe -0.19 përqind, respektivisht) (figura 2), dhe pritet të vazhdojnë të qëndrojnë negative edhe gjatë vitit 2018 dhe 2019. Ndërsa, yield-i i obligacioneve qeveritare

dhjetëvjeçare të eurozonës ka shënuar një rënie të lehtë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017, rreth nivelit 1 përqind. Projektionet e BQE-së tregojnë për një rritje graduale të yield-it dhjetëvjeçar në nivelin 1.3 përqind dhe 1.6 përqind për vitet 2018 dhe 2019, respektivisht.

Figura 2. Normat kryesore të interesit në Zonën Euro



Burimi: BQE (2018)

Aktiviteti kreditues në eurozonë ka shënuar përmirësim në tremujorin e katërt të vitit 2017, duke qenë në linjë me zhvillimet në aktivitetin ekonomik. Kredia totale ka shënuar një rritje vjetore prej 5.1 përqind, ndërkohë që gjatë vitit 2016, kjo rritje ka qenë rreth 3.3 përqind. Kontribuesi kryesor në rritjen e kreditimit ka qenë rritja e kredisë për ekonomitë familjare (3.3 përqind rritje vjetore), ndërsa rritja e kredive për ndërmarrjet ka ngelur e pandryshuar nga viti i kaluar (rreth 1.9 përqind). Ngjashëm me ecurinë e kreditimit dhe të aktivitetit ekonomik janë zhvilluar dinamikat e depozitave në sistemin bankar. Në tremujorin e fundit të vitit 2017, depozitat u rritën me rreth 3.9 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së kursimeve të ndërmarrjeve.

Në të njëjtën linjë me zhvillimet në eurozonë, aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor

gjatë TM3 2017 vazhdoi të përforcohet (tabela 1). Rritjen më të ulët e shënoi Maqedonia, rreth 0.2 përqind, pas një gjashtëmujori me rritje mesatare negative. Kjo ecuri e ngadaltë e ekonomisë së Maqedonisë është pasojë e ngërçit të tejzgjatur politik, i cili ka frenuar realizimin e shpenzimeve qeveritare. Ndërsa, Bosnja dhe Herzegovina ka shënuar përmirësim të ndjeshëm në tremujorin e tretë të vitit 2017 (rreth 2.3 përqind) krahasuar me pjesën e parë të vitit (-0.3 përqind).

Në dhjetor 2017, me përjashtim të Kosovës, të gjitha vendet e rajonit janë karakterizuar me rritje të shkallës së inflacionit në terma vjetorë, që kryesisht i atribuohet tendencës rritëse të pjesës më të madhe të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Serbia u karakterizua me shkallën më të lartë të inflacionit prej 3.0 përqind, pasuar nga Mali i Zi me shkallë mesatare prej 2.9 përqind. Ndërkohë në Maqedoni, inflacioni është rritur ndjeshëm krahasuar me muajin shtator duke arritur shkallën 2.4 përqind në dhjetor, që kryesisht reflekton zhvillimet pozitive të BPV-së në tremujorin e katërt. Në Shqipëri dhe Bosnje e Herzegovinë, inflacioni shënoi shkallën prej 1.8 përqind përkatësisht 1.7 përqind.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2015	2016	2017 T1	2017 T2	2017T3
Bosnja dhe Hercegovina	3.7	3.0	0.3	-0.6	2.3
Kosova	4.1	4.1	2.7	4.4	4.4
Mali i Zi	3.4	2.9	3.1	5.2	4.7
Maqedonia	3.8	2.9	0.0	-1.3	0.2
Serbia	0.8	2.8	1.1	1.4	2.1
Shqipëria	2.8	3.4	4.0	4.1	3.6

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistike të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve të sektorin bankar, tendencat e rritjes së kredive dhe depozitave kanë qenë shumë

të ndryshme ndërmjet vendeve të rajonit. Në tremujorin e katërt të vitit 2017, Shqipëria dhe Serbia kanë shënuar norma ndjeshëm më të ulta të rritjes së kreditimit dhe depozitave kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit 2016. Ndërsa, tre vendet e tjera, (Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Herzegovina) kanë shënuar përmirësime përsa i përket aktivitetit kreditues dhe rritjes së depozitave.


Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017, euro është vlerësuar me rreth 0.33 përqind krahasuar me shportën e monedhave të partnerëve kryesor tregtar të Kosovës. Kontribut në këtë vlerësim të monedhës euro kanë patur dollari amerikan (9.14 përqind), franka zviceriane (7.65 përqind), sterlina britaneze (2.09 përqind) dhe kuna kroate (0.14 përqind). Ndërsa ndaj lekut shqiptar dhe dinarit serb, monedha euro është zhvlerësuar me rreth 1.94 përqind dhe 3.66 përqind, respektivisht.

Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, me përjashtim të ushqimeve, kanë vazhduar ecurinë e tyre rritëse të shënuar gjatë vitit. Çmimi i naftës 'Brent' në tremujorin e katërt të 2017-ës arriti vlerën prej 61 dollarë për fuçi, duke regjistruar një rritje vjetore rreth 23 përqind (figura 3). Kjo rritje i atribuohet kryesisht zvogëlimit të gjendjes së inventarit në kushtet e përforcimit të kërkesës botërore, marrëveshjes ndërmjet vendeve të OPEC-ut dhe atyre jashtë saj për të reduktuar ofertën e naftës, dhe stabilizimit të prodhimit të naftës jo-konveccionalisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sipas projeksioneve të Bankës Botërore, gjatë vitit

2018, çmimet e energjisë priten të rriten me një normë më të ngadaltë se në vitin 2017, me rreth 4 përqind. Vlera mesatare e çmimit të naftës 'Brent' pritet të luhetet rreth vlerës 56 dollarë për fuçi, ndërkohë që gjatë vitit 2017, vlera mesatare ka qenë rreth 53 dollarë për fuçi. Megjithatë, ekzistojnë rreziqe të mundshme rreth këtij projeksioni, duke qenë se oferta e naftës nga vendet prodhuese por të karakterizuara nga mungesa e stabilitetit politik mund të jetë e luhatshme. Gjithashtu, marrëveshja ndërmjet anëtarëve të OPEC-ut dhe anëtarëve jashtë saj mund të rezultojë në reduktime më të thella të prodhimit të naftës ose në dështim të zgjatjes së kësaj marrëveshje, të cilat mund të gjenerojnë presione rritëse apo ulëse, respektivisht, në çmimin e naftës.

Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'




Burimi: Banka Botërore (2018)

Çmimet e metalit dhe mineraleve në terma vjetor u rritën me 19 përqind në tremujorin e fundit të vitit 2017 (figura 4), ndërkohë që rritja në nëntë muajt e parë të vitit 2017 ishte më e lartë (rreth 26 përqind). Kjo rritje më e ngadalësuar në tremujorin e fundit të vitit është rezultat i reduktimit të kërkesës në sektorët e infrastrukturës, prodhimit dhe pasurisë së patundshme në ekonominë e Kinës. Ecuria e çmimit të arit në fund të vitit 2017 u rrit me 4 përqind në

terma vjetor, duke arritur vlerën mesatare prej 1275 dollarë për ons, kryesisht si rezultat i dobësimit të monedhës së dollarit dhe kërkesës së qëndrueshme për investim.

Figura 4. Çmimet e Metaleve



Burimi: Banka Botërore (2018)

Rritja e çmimeve të metalit, sipas projeksioneve të Bankës Botërore, pritet të zbutet gjatë vitit 2018. Një rënie prej 10 përqind në çmimin e metalit të hekurit pritet të balancohet nga rritja e çmimeve e të gjithë metaleve të tjera kryesore, për shkak të shtrëngimit të ofertës së minierave të plumbit, nikelit dhe zinkut. Rreziqe të mundshme mbi çmimet e metaleve bazë mund të vijnë nga përforcimi i kërkesës në nivel global dhe reduktimet në prodhim. Ndërsa, çmimi i arit parashikohet të shënojë një rënie të lehtë gjatë vitit 2018 (rreth 1 përqind) për shkak të pritjeve të normave të larta të interesit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.


Në tremujorin e fundit të vitit 2017, çmimet e ushqimeve kanë vazhduar ecurinë e tyre rënëse të nisur prej muajit maj, duke shënuar rënie vjetore prej 1.3 përqind. Megjithatë, gjatë vitit 2018, çmimet e ushqimeve priten të stabilizohen, me një tendencë të lehtë rritëse si pasojë e tkurrjes së ofertës së tyre.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 shënoi një rritje vjetore prej 3.2 përqind. Kontributi kryesor në këtë rritje ka ardhur nga eksportet neto (mallra dhe shërbime) dhe investimet totale, me rreth 1.46 pikë përqindje dhe 1.10 pikë përqindje, respektivisht (figura 5). Kontributi pozitiv në rritje i eksporteve neto këtë tremujor krahasuar me tremujorin e vitit 2016 është rezultat i rritjes së eksporteve, veçanërisht atyre të shërbimeve.

Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë




Burimi: ASK (2017) dhe llogaritjet e BQK -së

Ndërsa, konsumi privat ka patur kontribut të lehtë pozitiv në rritjen reale të BPV-së në tremujorin e katërt të 2017-ës, me rreth 0.14 pikë përqindje, ndërkohë që ky kontribut në të njëjtën periudhë të vitit paraprak është luhatur rreth vlerës 3.15 përqind. Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat. Në tremujorin e katërt

të 2017-ës, remitencat, kompensimi i punëtorëve dhe kredia e re për konsum kanë përshpejtuar trendin e rritjes së tyre, duke shënuar rritje vjetore prej 10, 15 përkatësisht 60 përqind. Ndërkohë vlera më e ulët kontributit të konsumit privat në tremujorin e katërt të 2017 ndaj tremujorit të njëjtë të vitit 2016 i atribuohet kryesisht rritjes më të ngadaltë të importeve të mallrave të konsumit (figura 6).

Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit



Burimi: ASK (2017) dhe llogaritje të BQK-së


Kontributi pozitiv i investimeve totale i atribuohet kryesisht investimeve private, duke marrë në konsideratë se investimet publike gjatë tremujorit të katërt të 2017 kanë shënuar rënie prej 9 përqind në terma vjetorë.

Treguesit e tërthortë për investimet private ofrojnë sinjale të ndryshme në tremujorin e katërt të vitit 2017. Investimet e huaja direkte dhe kreditë e reja për investim janë rritur ndjeshëm në tremujorin e fundit, me rreth 85.4 përqind dhe 65.7 përqind, respektivisht, krahasuar me tremujorin e vitit paraardhës (figura 7). Ndërsa, importi i mallrave kapitale ka shënuar rënie prej 5.7 përqind. Gjithashtu, numri i bizneseve të reja, korrigjuar me

numrin e bizneseve të mbyllura, ka regjistruar rënie prej 14 përqind.

Sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 e kishte industria përpunuese (1.05 pikë përqindje), tregtia me shumicë e pakicë dhe riparimi i automjeteve e motoçikletave (0.95 pikë përqindje) dhe aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.97 pikë përqindje). Ndërsa, kategoria “shërbime të tjera” ka patur kontributin më të madh negativ (2.2 pikë përqindje) në rritjen e BPV-së reale.

Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private



Burimi: ASK (2017) dhe llogaritje të BQK-së

Për gjithë vitin 2017, ekonomia e Kosovës ka shënuar një rritje reale mesatarisht rreth 3.7 përqind, duke qëndruar poshtë rritjes mesatare të shënuar në vitin 2016 (rreth 4.1 përqind).

Sipas projeksioneve të BQK-së, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2018 do të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me të dhënat aktuale të vitit 2017, duke u luhatur në një interval prej 4.2 përqind në 4.4 përqind. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet stimulit të përforcuar fiskal gjatë vitit 2018, veçanërisht ai i gjeneruar nga shpenzimet kapitale të qeverisë.

Remitancat dhe aktiviteti kredidhënës, edhe gjatë vitit 2018, do të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik. Ambienti i jashtëm do të jetë favorizues për bilancin tregtar, si rezultat i rritjes më të ngadaltë të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare dhe një rishikim për lartë të aktivitetit ekonomik në vendet partnere tregtare të Kosovës.


Në linjë me zhvillimet në aktivitetin ekonomik, në tremujorin e katërt të vitit 2017, shkalla e punësimit u rrit lehtësisht në 29.8 përqind krahasuar me vlerën 29.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pavarësisht kësaj, norma e papunësisë u luhet rreth vlerës 30.6 përqind në tremujorin e katërt të vitit 2017 ndërkohë që në tremujorin e fundit të vitit 2016 kjo normë regjistroi një vlerë më të ulët, rreth 28.7 përqind. Arsyeja pse rritja e shkallës së punësimit nuk është reflektuar në reduktimin e normës së papunësisë qëndron në rritjen e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vlerën 42.9 përqind në fund të vitit 2017 krahasuar më shkallën prej 41.3 përqind në fund të vitit 2016. Tendencat e treguesve kryesorë të punës të shënuar gjatë tremujorit të katërt janë të njëjta me zhvillimet e regjistruara gjatë gjithë vitit 2017.

Çmimet

Si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik në vend, niveli i përgjithshëm i çmimeve në Kosovë, shprehur nëpërmjet indeksit të çmimeve të konsumit, është karakterizuar me rritje mesatare prej 1.5 përqind në vitin 2017. Gjysma e parë e vitit është karakterizuar me një rritje më të lartë të çmimeve ndërsa në gjysmën e dytë, veçanërisht në tremujorin e fundit,

norma e rritjes së çmimeve ishte më e ulët, 0.7 përqind (figura 8).

Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2018)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, gjatë TM4 2017, me rritje u karakterizuan çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (3.1 përqind), pasuar nga çmimet e ushqimit dhe pijeve jo-alkoolike (2.0 përqind), çmimet e restoranteve dhe hoteleve (1.3 përqind), etj. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek çmimet e rrymës, gazit e lëndëve tjera djegëse (2.4 përqind), kryesisht për shkak të modifikimit të tarifave të energjisë elektrike në prill të vitit 2017. Rënie është shënuar edhe tek çmimet e rekreacionit dhe kulturës (1.4 përqind) si dhe tek mjetet e komunikimit (1.0 përqind) (figura 9).


Siç shihet në figurën 8, inflacioni bazë i cili përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin, ka qenë më stabil se sa lëvizja e inflacionit të përgjithshëm gjatë vitit 2017 ndërkohë që në TM4 2017 inflacioni bazë ishte negativ në nivelin prej -0.1 përqind.

Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Ky nivel më i ulët i inflacionit bazë është rezultat i pjesëmarrjes shumë të lartë që e kanë në shportën e konsumatorit kosovarë produktet që karakterizohen me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqimi, energjia, pijet alkooolike dhe duhani) por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar.


Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Dinamika që e ka përcjellë nivelin e çmimeve në Kosovë gjatë vitit 2017 përgjithësisht dhe tremujorit të katërt veçanërisht, përveç rritjes së aktivitetit ekonomik i atribuohet edhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi. Indeksi i çmimeve


të importit në TM4 2017 shënoi rritje prej 2.5 përqind (figura 10).

Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Çmimet e produkteve bimore, metaleve bazë dhe produkteve minerale, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (15.6, 12.9 përkatësisht 7.4 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujt e saj si dhe çmimet e lëkurës shënuan rënien më të lartë të çmimeve (10.8 përkatësisht 4.0 përqind) (figura 11).

Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Indeksi i çmimeve të prodhimit në TM4 2017 u karakterizua me rritje prej 1.6 përqind. Në këtë periudhë, me rritje të çmimeve u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit, prodhimi i drurit,

prodhimi i lëkurës, etj. Ndërsa, me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht prodhimi i pijeve, prodhimi i mobileve, etj. (figura 12).

Regjistri i bizneseve

Në vitin 2017 është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara dhe po ashtu numër më i vogël i ndërmarrjeve të mbyllura. Trendi në ngjashëm e ka karakterizuar edhe tremujorin e fundit të vitit 2017, ku janë regjistruar 1,921 ndërmarrje të reja apo 330 ndërmarrje më pak se sa në TM4 2016, ndërsa janë mbyllur 432 ndërmarrje apo 87 ndërmarrje më pak (figura 13).


Figura 13. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2018)

Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve të reja, trendi ka vazhduar të jetë relativisht i ngjashëm me tremujorët paraprakë. Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 511 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i hotelerisë me 183 ndërmarrje, sektori i ndërtimtarisë me 180 ndërmarrje, etj. (figura 14).

Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e bujqësisë janë regjistruar 103 ndërmarrje më pak, në sektorin e prodhimit 80 ndërmarrje më pak, në sektorin e tregtisë 76 ndërmarrje më pak, etj. Sektorët kryesorë që shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i shëndetësisë dhe ai i informacionit dhe komunikimit, ku u regjistruan nga 11 ndërmarrje më shumë krahasuar me TM4 2016.

Sektori Fiskal

Gjatë vitit 2017, sektori fiskal u karakterizua me performancë të mirë të të hyrave buxhetore dhe rritje të shpenzimeve buxhetore. Përkundër rritjes së vazhdueshme të të hyrave, Kosova ka shkallën më të ulët të ngarkesës së ekonomisë me tatime krahasuar me vendet e rajonit. Raporti i të hyrave buxhetore ndaj BPV-së në vitin 2017 ishte 26.1 përqind krahasuar me mesataren e rajonit prej 37.0 përqind. Në të njëjtën periudhë, raporti i shpenzimeve buxhetore prej 27.0 përqind të BPV-së ishte më i ulët krahasuar me mesataren e rajonit prej 39.5 përqind.

Të hyrat buxhetore¹ në vitin 2017 arritën vlerën prej 1.68 miliardë euro apo 5.3 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore indirekte të cilat janë të ndërlidhura me lëvizjen e importit i cili ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2017. Të hyrat indirektet arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro (7.2 përqind rritje). Me rritje u karakterizuan edhe të hyrat tatimore direkte të cilat arkëtohen nga tatimi në të ardhura dhe pasuri. Këto të hyra shënuan rritje prej 2.5 përqind dhe arritën vlerën prej 238.0 milionë euro. Të hyrat jo-tatimore, që kryesisht janë të hyra nga organizatat buxhetore, shënuan rritje prej 6.0 përqind dhe arritën vlerën 185.8 milionë euro.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore² arritën vlerën prej 1.74 miliardë euro që paraqet një rritje vjetore prej 5.0 përqind. Gjatë vitit 2017 të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga dhe mëditje shënuan rritje të lehtë prej 1.2 përqind dhe arritën vlerën prej 550.0 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 6.7 përqind dhe arritën vlerën prej 506.4 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 26.9 përqind të gjithsej shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 5.4 përqind dhe arritën vlerën 467.5 milionë euro.

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe komunalitë) shënuan rritje për 11.4 përqind dhe arritën vlerën prej 226.0 milionë euro.

Duke pasur parasysh këtë rritje pothuajse të njëjtë të të hyrave dhe shpenzimet, buxheti i Kosovës regjistroi deficit të ulët buxhetor prej 59.0 milionë euro krahasuar me deficitin prej 61.1 milionë euro në vitin 2016, përderisa si përqindje e BPV-së, deficitin primar në vitin 2017 ishte 0.9 përqind nga 1.0 përqind sa ishte në vitin 2016.

Borxhi publik, në vitin 2017, ka arritur në 996.4 milionë euro që është për 16.8 përqind më i lartë krahasuar me vitin 2016. Dinamika e rritjes së borxhit publik i ka karakterizuar të gjithë tremujorët e vitit 2017, ndërkohë që vetëm në TM4 2017 borxhi publik është rritur për 31.1 milionë euro, ku borxhi i brendshëm publik është rritur për 34.9 milionë euro ndërsa borxhi i jashtëm publik është zvogëluar për 3.8 milionë euro.

Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 19.9 përqind (i cili ka arritur në 574.3 milionë euro), si dhe borxhit të jashtëm publik i cili ka shënuar rritje prej 12.9 përqind duke arritur në 422.2 milionë euro. Pra, pjesa më e madhe e borxhit publik (57.6 përqind) është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj bankave komerciale (42 përqind), institucioneve publike (35 përqind), fondeve pensionale (18 përqind), etj. Pjesa tjetër e borxhit publik (42.4 përqind) është borxh i jashtëm, që kryesisht i përket Fondi Monetar Ndërkombëtar me 38.1 përqind, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim

dhe Zhvillim me 37.5 përqind, Agjencia Gjermane për Rindërtim me 13.0 përqind, etj.

Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.6 përqind nga 14.6 përqind sa ishte në vitin 2016. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqind.

Sektori i Jashtëm


Gjatë vitit 2017, sektori i jashtëm është karakterizuar me zhvillime pozitive në llogarinë rrjedhëse por edhe në atë financiare. Deficiti i llogarisë rrjedhëse në raport me BPV-në është ulur në 6.4 përqind nga 7.9 përqind sa ishte në vitin 2016, ndërsa bilanci i llogarisë financiare ka arritur në 5.1 përqind të BPV-së nga 3.3 përqind sa ishte në vitin 2016.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse në vitin 2017 ka shënuar vlerën prej 413.2 milionë euro apo është zvogëluar për 14.2 përqind krahasuar me vitin paraprak. Vetëm në TM4 2017, deficiti i llogarisë rrjedhëse ka shënuar vlerën prej 232.7 milionë euro, që është për 3.4 përqind më i ulët krahasuar me TM4 2016. Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së suficitit në bilancin e shërbimeve dhe llogarisë së të ardhurave dytësore, ndërsa deficiti në tregtinë e mallrave ka shënuar rritje.

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën prej 2.7 miliardë euro në vitin 2017, që paraqet një rritje vjetore prej 7.6 përqind. Rritja e çmimeve, sidomos

atyre të metaleve, por edhe rritja e kërkesës së jashtme, ka ndikuar në përsheptimin e rritjes së eksportit të mallrave. Gjatë vitit 2017 eksporti i mallrave ka arritur nivelin prej 378.0 milionë euro që është për 22.1 përqind më i lartë krahasuar me vitin paraprak, rritje kjo ndër më të lartat në vitet e fundit. Si rezultat i rritjes së eksportit të mallrave, raporti ndërmjet eksportit dhe BPV-së është përmirësuar në 6.0 përqind nga 5.1 përqind sa ishte në vitin paraprak.

Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK (2018)

Dinamika e rritjes ka vazhduar edhe në TM4 2017, megjithëse me një trend më të ngadalësuar. Eksporti i mallrave në TM4 2017 ka arritur vlerën prej 93.6 milionë euro, që përkon me një rritje vjetore prej 11.8 përqind (figura 15).³

Rritja e vlerës së eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori kryesisht i atribuohet rritjes së eksportit të metaleve bazë, plastikës dhe gomës, tekstilit, pijeve dhe duhanit, etj. Në anën tjetër, me rënie u karakterizua eksporti i produkteve minerale, lëkurës, këpucëve, etj. (figura 16).

³ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2018)

Si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme në vend, me rritje të konsiderueshme është karakterizuar edhe importi i mallrave. Gjatë vitit 2017, vlera e importit të mallrave ka arritur në 3.0 miliardë euro (rreth 47.3 përqind e BPV-së), që është për 9.2 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak. Dinamika e rritjes së importit të mallrave është përshpejtuar në gjysmën e dytë të vitit 2017, ku vetëm në TM4 2017, vlera e gjithsej mallrave të importuara arriti në 830.1 milionë euro dhe shënoi një rritje vjetore prej 11.0 përqind. Rritja e importit ishte kryesisht rezultat i rritjes së produkteve minerale, ku përfshihet importi i naftës dhe derivateve të saj, çmimet e të cilave janë rritur në tregjet ndërkombëtare. Me rritje është karakterizuar edhe importi i automjeteve, metaleve bazë, perimeve, etj. (figura 17). Në anën tjetër, importi i këpucëve, lëkurave dhe artikujve të tyre, etj. shënuan rënie. Në TM4 2017, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte ishte e ngjashme me TM4 2016 (11.3 përqind).

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 77.1 milionë euro në TM4 2017, një rritje prej 47.5 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016.

Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 21.4 përqind, duke arritur në 202.2 milionë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 9.4 përqind dhe arriti në 125.1 milionë euro.

Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)


Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit përbëjnë kategorinë kryesore (60.9 përqind e gjithsej eksportit të shërbimeve) dhe shënuan rritjen më të lartë, ndërsa shërbimet e ndërtimit shënuan rënie. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e biznesit dhe shërbimet e udhëtimit shënuan rritje, ndërsa shërbimet kompjuterike dhe shërbimet e mirëmbajtjes dhe riparimit shënuan rënie.

Llogaria e të ardhurave parësore u karakterizua me bilanc prej 35.4 milionë euro në TM4 2017, që është për 6.5 përqind më i ulët krahasuar me TM4 2016. Bilanci pozitiv i të ardhurave nga kompenzimi i punonjësve⁴ shënoi rritje për 15.9 përqind, ndërsa bilanci negativ i të ardhurave nga investimet u rritë

⁴ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qëndrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

për 90.7 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 12.7 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore, gjatë vitit 2017 arritën vlerën prej 759.2 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 9.9 përqind. Të gjithë tremujorët e vitit 2017 janë karakterizuar me rritje të theksuar të remitencave, ndërkohë që vetëm në TM4 2017, remitencat e pranuar në Kosovë arritën në 205.2 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 19.0 përqind (figura 18).

Figura 18. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)


Rritja e remitencave mund t'i atribuohet, deri në një masë, rritjes së aktivitetit ekonomik në Eurozonë dhe Zvicër, duke qenë se remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra. Remitencat që pranohen nga këto dy vende kanë një pjesëmarrje prej 38.0 përkatësisht 22.2 përqind në gjithsej remitencat. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.8 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.

Edhe llogaria financiare është përmirësuar në mënyrë të theksuar gjatë vitit 2017, gjë që nënkupton më shumë investime në ekonominë e Kosovës nga ana e jo-rezidentëve. Llogaria financiare gjatë vitit 2017 ka shënuar bilancin prej -330.0 milionë euro, që është për 65.8 përqind më shumë krahasuar me vitin paraprak. Vetëm në TM4 2017, llogaria financiare ka shënuar nivelin prej -116.4 milionë euro, krahasuar me bilancin prej -101.6 milionë euro në TM4 2016. Detyrimet shënuan vlerën prej 134.6 milionë euro, që është dukshëm më e lartë krahasuar nivelin prej 48.4 milionë euro të shënuar në TM4 2016, ndërsa asetet shënuan vlerën prej 18.3 milionë euro ndërkohë që në TM4 2016 ishin -53.3 milionë euro.

Në kuadër të detyrimeve, kategoria kryesore ishin Investimet e Huaja Direkte (IHD), të cilat në vitin 2017 arritën vlerën prej 287.8 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 30.8 përqind. Vetëm në TM4 2017, IHD-të në Kosovë ishin në nivelin prej 73.7 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 103.0 përqind. Rritja e IHD-ve në këtë periudhë reflekton, përveç fluksit më të lartë të hyrjes së IHD-ve, edhe shpërndarjen më të ulët të dividendës krahasuar me vitin 2016. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rritje u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, ndërsa investimet në instrumente të borxhit shënuan rënie (figura 19).

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, që përbën rreth 88.6 përqind të gjithsej IHD-ve, arriti vlerën prej 65.3 milionë euro dhe shënoi rritje prej 129.5 përqind. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit arritën vlerën prej 8.4 milionë euro, një rritje prej 7.0 përqind.

Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Rritje më e lartë e IHD-ve u shënua në sektorin e shërbimeve financiare dhe në patundshmëri (62.7 përkatësisht 9.5 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar), përderisa në sektorin e industrisë dhe shërbime të tjera u shënua rënie e lehtë e IHD-ve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në TM4 2017 (17.5 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 14.8 milionë euro, Mbretëria e Bashkuar me 12.7 milionë euro, etj. Në anën tjetër, IHD-të nga Turqia dhe Holanda u zvogëluan për 2.9 përkatësisht 3.1 milionë euro.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 21 TM4 2017, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat ë tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	2016	2017
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	6,070.1	6,282.2
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	0.3%	1.5%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.3%	0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,596.5	1,681.5
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,657.6	1,740.5
Bilanci primar (në milionë euro)	-61.1	-59.0
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,386.9	5,917.1
prej të cilave: Bankat	3,637.1	3,877.5
Kredi	2,230.0	2,485.3
Depozita	2,897.8	3,092.5
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.2%	6.8%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.2%	1.3%
Hendeku i normës së interesit	6.0%	5.5%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-467.2	-425.1
prej të cilave: remitencat e pranuar	691.0	759.2
Llogaria financiare	-199.1	-330.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	220.0	287.8
Investimet portfolio, net	343.6	14.7
Investimet tjera, net	-264.0	-164.7
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-81.0	-120.1
Asetet	4,547.7	4,824.4
Detyrimet	4,628.7	4,944.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,015.1	2,091.6
Borxhi i jashtëm privat	1,570.5	1,598.3
Borxhi i jashtëm publik	444.6	493.3

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

